

RAPORT I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2026, PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA SASPAC

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1.Përmbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2026, SASPAC ka realizuar procesin e konsultimit publik si dhe ka miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Udhërrëfyesin për OZHQ 2025-2030, në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, i cili përcakton kryerjen e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike kombëtare.

Gjithashtu është publikuar dhe raporti individual për rezultatet e konsultimit publik, për këtë projektvendim, duke përmbushur parimin e reagueshmërisë dhe llogaridhënies së këtij procesi.

Ky raport paraqet rezultatet e procesit të konsultimit publik për projektvendimin “Udhërrëfyesi për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026–2030”, i cili synon miratimin e dokumentit strategjik që orienton zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm në Shqipëri.

Procesi i konsultimit publik u zhvillua në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik. Projektakti u publikua në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) gjatë periudhës 3 prill – 6 maj 2026, duke garantuar transparencën dhe mundësinë e pjesëmarrjes së publikut dhe aktorëve të interesuar.

Gjatë periudhës së konsultimit publik, në Regjistrin Elektronik u regjistruan rreth 300 shikime të projektaktit. Nga procesi i konsultimit u paraqitën 20 komente, të cilat u shqyrtuan nga grupi i punës dhe u pranuan. Komentet lidheshin me metodologjinë për përcaktimin e objektivave të indikatorëve sasiorë të OZHQ-ve, përmes përdorimit të metodologjisë “Nearest Neighbour (NN)”, si dhe me përmirësime terminologjike dhe përditësime teknike të draftit të Udhërrëfyesit. Të gjitha sugjerimet e pranuar u reflektuan në versionin përfundimtar të dokumentit.

Procesi i konsultimit konfirmoi mbështetjen institucionale për dokumentin dhe kontribuoi në përmirësimin e cilësisë së tij, duke forcuar bazën metodologjike dhe koherencën me kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar të zhvillimit të qëndrueshëm.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Gjatë periudhës së raportimit është hartuar dhe proceduar me miratimin e projektvendimit “Për miratimin e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026–2030”. Projektakti iu nënshtrua procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përpara miratimit të tij.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Gjatë periudhës së raportimit, 1 (një) projektakt është konsultuar publikisht në përputhje me legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik. Nuk ka pasur akte që janë proceduar pa iu nënshtruar procesit të konsultimit publik.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Për aktin e konsultuar nuk është përgatitur raport i vlerësimit të ndikimit rregullator.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Gjatë periudhës së raportimit nuk është përdorur asnjë nga kriteret ose përgjashtimet e parashikuara nga legjislacioni për zhvillimin e konsultimeve publike. Projektvendimi “Për miratimin e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026–2030”, si dokument strategjik, iu nënshtrua plotësisht procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. Për rrjedhojë, nuk ka pasur akte për të cilat konsultimi publik është përgjashtuar dhe nuk ka arsye për moszhvillimin e konsultimit publik.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Gjatë periudhës së raportimit është konsultuar publikisht 1 (një) projektakt, i cili i përket kategorisë së projekt vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM).

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Nuk ka ndryshime thelbësore në krahasim me vitin e kaluar.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorur për konsultimin e projektvendimit, ishte:

- Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) – 1 konsultim (publikimi i projektaktit gjatë periudhës 3 prill – 6 maj 2026);
- Dërgimi i projektaktit për komente tek institucionet dhe aktorët e përfshirë në proces;
- Takime teknike ndërinstytucionale – mbi 20 takime pune të zhvilluara gjatë periudhës 2023–2025 në fazën e hartimit të dokumentit.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda e konsultimit që gjeneroi komentet ishte konsultimi i drejtpërdrejtë me institucionet dhe organizatat e përfshira në procesin e hartimit të dokumentit, nëpërmjet dërgimit të projektaktit për komente dhe konsultimeve teknike ndërinstytucionale. Ndërkohë, gjatë konsultimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP), megjithëse u regjistruan rreth 300 shikime të projektaktit, nuk u paraqit asnjë koment.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po. Institucioni ka organizuar konsultime paraprake gjatë fazave të hershme të hartimit të projektaktit. Konkretisht, gjatë periudhës 2023–2025 janë zhvilluar mbi 20 takime teknike ndërinstytucionale me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare, institucioneve të arsimit të lartë dhe ekspertëve teknikë. Këto konsultime kanë shërbyer për hartimin e dokumentit, përzgjedhjen e treguesve strategjikë dhe përcaktimin e objektivave për vitin 2030, përpara zhvillimit të konsultimit formal, publik.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Projektvendimi “Për miratimin e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026–2030” ka qëndruar i publikuar në RENJK, për 20 (njëzetë) ditë.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit publik ishte 20 ditë pune, në përputhje me afatin e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata paraqet përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme, si në respektimin e afateve, ashtu edhe në planifikimin e gjithë procesit të konsultimit.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në procesin e hartimit të projektaktit morën pjesë 7 aktorë të jashtëm jo-qeveritarë, përfshirë 3 organizata ndërkombëtare (UN, FAO dhe EEAS), 2 institucione të arsimit të lartë (Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Mesdhetar i Tiranës), si dhe ekspertë teknikë të angazhuar në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Struktura e anëtarëve të jashtëm përbëhej nga organizata ndërkombëtare (UN, FAO dhe EEAS), institucione të arsimit të lartë (Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Mesdhetar i Tiranës), si dhe ekspertë individualë të angazhuar në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm. Nuk kanë marrë pjesë përfaqësues të kompanive apo organizatave të shoqërisë civile.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Në procesin e konsultimit u paraqitën komente nga 3 palë të interesuara: UN, UN Women dhe United Nations Environment Programme (UNEP). Në total u shqyrtuan 20 komente, të cilat u pranuan dhe u reflektuan në versionin përfundimtar të projektaktit.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Kontributet në procesin e konsultimit publik janë dhënë nga persona juridikë, konkretisht nga organizata ndërkombëtare (UN, UN Women, United Nations Environment Programme – UNEP etj).

Nuk janë regjistruar komente nga persona fizikë, ndërmarrje apo shoqata të tjera.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Procesi i konsultimit është zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore, duke siguruar përfshirjen e institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, si dhe reflektimin e komenteve të marra në dokumentin përfundimtar.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Gjatë periudhës së raportimit janë marrë gjithsej 20 komente/rekomandime.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Nga 20 komentet/rekomandimet e marra, 20 u pranuan, ndërsa nuk pati komente të pranuar pjesërisht apo të refuzuara.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, mbetet e kënaqshme, duke theksuar një përmirësim, krahasuar me vitet e kaluara.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Nuk është hartuar raport i vlerësimit të ndikimit rregullator VNR, për projektvendimin “Udhërrëfyesi për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026–2030”.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Gjatë periudhës së raportimit, institucioni publikoi 1 (një) raport të konsultimit publik.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyt?

Nuk ka raste të raporteve të konsultimit publik, të papublikuara. Raporti i konsultimit publik për projektaktin është publikuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

SASPAC vlerëson se procesi i konsultimit publik për projektvendimin është zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, duke garantuar transparencën, aksesin në informacion dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfidë mbetet rritja e pjesëmarrjes së publikut në konsultimet e hapura, veçanërisht përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP). Në të ardhmen do të synohet zgjerimi i përfshirjes së palëve të interesit dhe forcimi i komunikimit publik, me qëllim zhvillimin e konsultimeve më gjithëpërfshirëse dhe përmirësimin e cilësisë së dokumenteve strategjike.